



REPUBLIKA SHQIPËRISË

GJYKATA E RRETHIT GJYQËSOR VLORË

Nr.463 Akti

Datë e regj. 03.09.2012

Nr.463Vendimi

Datë 04.10.2012

VENDIM
“NË EMËR TË REPUBLIKËS “

Gjykata e Shkallës së Parë Vlorë e përbërë nga:

GJYQTAR - SKENDER HALUCI

Asistuar prej sekretares së seancës gjyqësore **Xhuljeta Dinaj**, sot më datë 04.10.2012 në Vlorë, në seancë gjyqësore me dyer të hapura, mori në shqyrtim çështjen penale Nr463 Akti, që u përket palëve:

KERKUES :

[REDACTED] I biri i [REDACTED] dhe [REDACTED] dtl.30.08.1982, Lindur ne Drashovice dhe banues ne Vlore, Lagja [REDACTED], Rruga [REDACTED] pallati prane postes se Coles, me arsim te larte, I martuar, I padenuar, me shtetesi e kombesi shqiptare, mbrojtur ne kete gjykim nga Av [REDACTED] I zgjedhur prej tij.

OBJEKTI :

- Humbja e fuqise se sekuestrimit te llogarive bankare ne Banken Kombetare Tregtare me Nr.528497211 dhe Nr.408069406, dhe ne Intesa Sanpaolo Albania me Iban Al 212082602600000 64832237101 te vendosura me vendimin Nr.483 date 25.11.2011 dhe vendimin Nr.478, date 23.11.2011 te Gjykates se Rrethit Gjyqesor Vlore.

Person I interesuar:

Prokuroria e Rrethit Gjyqesor Vlore perfaqesuar nga Prokurori [REDACTED]

Baza Ligjore:

Neni 210 e 275 e vijnes te K.Pr.Penale

Ne perfundim te shqyrtimit gjyqesor te kesaj ceshtjeje gjykata pasi degjoi palet qe kerkuan:

-Kerkuesi dhe mbrojtasi I zgjedhur prej tij Av. [redacted] Humbjen e fuqise se sekuestrimit te llogarive bankare ne Banken Kombetare Tregtare me Nr.528497211 dhe Nr.408069406, dhe ne Intesa Sanpaolo Albania me Iban Al 212082602600000 64832237101 te vendosura me vendimin Nr.483 date 25.11.2011, dhe vendimin Nr.478, date 23.11.2011 te Gjykates se Rrethit Gjyqesor Vlore.

-Prokurore [redacted] te ne cmim te gjykates;

Si dhe shqyrtoi aktet bashkengjitur kerkeses dhe ceshtjen ne teresi,

VEREN

Gjykata e Rrethit Gjyqesor Vlore mbi bazen e kerkeses e Prokurorise Prane Gjykates se Rrethit Gjyqesor Vlore, me Vendimin Nr.478 date 23.11.2011, dhe vendimin Nr.483 date 25.11.2011, ka vendosur sekuestrimin e llogarive bankare ne Banken Kombetare Tregtare me Nr.528497211 dhe Nr.408069406, dhe ne Intesa Sanpaolo Albania me Iban Al 212082602600000 6483223710 ne emer te shtetasit [redacted] per shkak te procedimit penal nr.1434, te vitit 2011 ne ngarkim te kerkuesit akuzuar per vepren penale te "Pastrimi I produkteve te vepres penale" parashikuar nga neni 287 I K.Penal

Pas perfundimit te hetimeve nga organi I akuzes nuk ka rezultuar se nga ana e kerkuesit [redacted] te jete kryer ndonje nga format e anes objective te vepres penale te "Pastrimi I produkteve te vepres penale" parashikuar nga neni 287 I K.Penal, kerkyesi nuk rezultonte autor I kembimit ose transferimit te pasurive, kryerjes se veprimeve financiare apo transakcioneve te copezuara.

Ne keto kushte, Prokuroria e Rrethit Gjyqesor Vlore, me vendimin e saj te dates 15.05.2012 ka vendosur:

- Pushimin e ndjekjes penale ne ngarkim te shtetasit [redacted] ne procedimin penal nr.1434, te vitit 2011, per shkak se nuk provohet qe personi nen hetim te kete kryer vepren penale.
- Te njoftoj me kete vendim personin nen hetim dhe te demtuarin, te cilet mund te bejne ankim ne Gjykatën e Rrethit Gjyqesor Vlore, brenda 10 (dhjete) diteve nga njoftimi I vendimit.

Gjykata konstaton se bazuar ne nenin 275 te K.Pr.Penale (Humbja e fuqise se sekuestrimit) paragrafi I pare I ketij neni ne te cilin percaktohet se:

"Me vendimin e pafajesise ose te pushimit te ceshtjes, gjykata ose prokurori urdheron qe sendet e sekuestruar t'I kthehen atij qe I takojne, kur nuk duhet te urdheroje konfiskimin e tyresepse kane sherbyer ose ishin te destinuaraper te kryer nje veper penale ose sepse kane qene prodhim ose perfitim nga vepra penale".

Vendimet e sekuestros dhene nga Gjykata e rrethit Gjyqesore Vlore, e kane humbur fuqine e tyre.

Ne keto rrethana dhe mbi percaktimin e ligjit gjykata vlereson se: kerkesa e kerkuesit [redacted] duhet te pranohet si bazuar ne prova e ne ligj.

PER KETO ARESYE

Gjykata në bazë të neneve 379 e 275 te K.Pr.Penale

VENDOSI:


- Pranimin e kerkeses se kerkuesit [redacted]
- Humbjen e fuqise se sekuestrimit te llogarive bankare ne Banken Kombetare Tregtare me Nr.528497211 dhe Nr.408069406, dhe ne Intesa Sanpaolo Albania me Iban Al 212082602600000 64832237101 te vendosura me vendimin Nr.483 date 25.11.2011, dhe vendimin Nr.478, date 23.11.2011 te Gjykates se Rrethit Gjyqesor Vlore, ne dem te kerkuesit [redacted]
- Kunder vendimit lejohet ankim ne Gjykatën e Apelit Vlore, brenda 10 diteve.

U shpall ne Vlore, sot date 04.10.2012.

SEKRETARE
Xhuljeta Dinaj



GJYQFAR
Skender Haluci



15.10.2012

